

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“ITALIAN SOUND” sh.p.k**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 **“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”**, vendosëm hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë :

Sot ne date 23.07.2019, ortaket :

- **EBANO ISUFAJ**, i lindur më **15.01.1989**, ne **Vlore** dhe banues ne **Vlore** posedues i leternjoftimit me numër personal **I90115092N**.
- **LUIXHINO ISUFAJ**, i lindur më **15.06.1993**, ne **Vlore** dhe banues ne **Vlore** posedues i leternjoftimit me numër personal **J30615107G**.

me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, te shprehur nepermjet ketij akti themelimi, vendosen per krijimin e shoqerise tregtare **“ITALIAN SOUND” sh.p.k.** me kushtet e meposhteme :

Neni 1

EMERTIMI

Shoqeria Tregtare do te ketë Emërtimin **“ITALIAN SOUND” Shpk.**

Neni 2

FORMA JURIDIKE

Shoqëria Tregtare **“ITALIAN SOUND” Shpk**, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar.

Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 **“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”**, ku ne nenin 3 përcaktohet se:

“Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 **“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.**

Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”

Neni 3

KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë **“ITALIAN SOUND” Sh.p.k** do te vazhdoje veprimtarine e saj me një afat kohor te pakufizuar.



Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullim veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Përqendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Ortaket e shoqërisë marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në këtë dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqëri në likuidim ” e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e shoqërisë.

Nëse Ortaket e shoqërisë nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 3 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 4

SELIA

Shoqëria Tregtare “**ITALIAN SOUND**” **Sh.p.k** e ka selinë në qytetin e Vlores, Lagjia “Maji”, Prane karburantit Vola Karburant, kati i dyte.

Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakeve të Shoqërisë.

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQËRISË

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

- **Aredim, Restaurime, Mobilim, Kontabilitet, Menaxhim, Logjistike, Tregti, Import Ekport, Prodhim, Tregti shumice/pakice, Kultivim Agrikulture, Sherbime mekanike Restorant-Hoteleri, Infrastruktura (rruge, hekurudha, porte), Turizem, Gastronomia ndertime teknologjike, transport brenda dhe jashte vendit, prodhim dhe ndertim të materjaleve metalike, ndertime civile, projektme , prodhime bujqesore, etj.**

Ne fushen e transportit të udhetareve, urban, interurban e internacional, transport e tregtim materialesh e mallrash të ndryshme, eksport-import etj.

Import, eksport dhe tregtimi me pakice dhe shumice të artikujve të ndryshëm industrial dhe ushqimor, elektroshtepiake, elektrike, pjesë këmbimi, materialeve të ndertimit, lende të parë, makineri si dhe transporti i tyre brenda dhe jashte vendit. Projektimi dhe zbatimi, ndertime civile, turistike, bujqesore, ujesjelles kanalizime rikonstruksione godinash civile, dhe ekonomike, prodhime e tregtim të materialeve të ndertimit, blerje dhe shitje të mjeteve të ndryshme, transport mallrash, shitje me shumice dhe pakice të produkteve bujqesore, bimore.

Sherbime te hotelerie, bar-restorante si dhe tregtim me pakice dhe shumice karburanteve dhe tregtise me shumice e pakice te madhrave te ndryshem etj. Blerje dhe shitje dhe menaxhimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të pasurive në emër të tyre dhe në emër të palëve të treta. Prodhim dhe tregtim te materialeve te ndertimit si dhe te betoneve te markave te ndryshme , Import, eksport dhe tregeti me pakice dhe shumice te lendeve djege .

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve themelues i vleren 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe ndahet ne dy kuota nga te cilat:

- **Ebano Isufaj, nje kuote me 50 %**
- **Luixhino Isufaj, nje kuote me 50 %**

Neni 7

TRANSFERIMI I KUOTEVE

Kuotat e kapitalit jane lirisht te Transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaku qe kerkon shese kuoten e tij nje personi te trete, duhet detyrimisht tu njoftoj ortakeve te shoqerise blerjen e kuotave te tij ne te njejtat kushte si personit te trete te cilit ai deshiron t'ia shes. Kur disa ortake ushtrojne te drejten e tyre te parablerjes dhe shprehin deshiren e tyre per te blere kuoten, ortaku shites gezon te drejten diskrecionale per te zgjedhur se cilit ortak deshiron ti shese totalishte ose pjeserishte kuotat e tij. Ortaket duhet te pergjigjen brenc 30 diteve nese deshirojne te blejne kuotat e ofruara apo jo.

Neni 8

SHPERNDARJA E FITIMIT

Ortaket financojne, perfitojne rimbursim te financimit te tyre dhe ndajne fitimin e tyre ne baze te kuotave ne kapitalin themeltare.

Neni 9

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet Drejtuese te Shoqërisë janë :


- 1.Administratori,
 - 2.Asamblea e Pergjithshme e Zakonshme ose e Jashtezakonshme e Ortakeve.
- Aministratori i Shoqërisë është Ebano Isufaj per nje periudhe 5 vjecare.**

Neni 10

KOMPETENCAT E ADMNISTRATORIT

Administratori ushtron kompetenca ne emer te Shoqerise:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



- d) përgatis dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetem edhe në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda muajve në vazhdim dhe
- b) kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, dhe rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,
- c) Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat më përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
- d) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11

Veprimtaria ekonomike dhe financiare e shoqërisë ndahet në periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon nga data 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik, me përjashtim të vitit të parë i cili fillon nga data e krijimit të shoqërisë dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shoqëria mban dokumentacionin e nevojshëm financiar për administrimin e pasurisë dhe për zhvillimin e të gjithë veprimtarisë së saj, në përputhje me kërkesat e të gjithë legjislacionit përkatës në fuqi.

Bilanci financiar i shoqërisë përpilohet në bazë të raportit me shkrim të eksperteve kontabile të autorizuar dhe të raportit të paraqitur nga administratorët brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Të dy raportet paraqiten me miratohen në asamblesë të ortakëve brenda datës 30 qershor.

Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit meparshem,shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete,si c fondet financiare qe perbejne rezerven e detyrueshem.

Neni 13

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se shoqerise zgjidhen nga vete ortakët e shoqerise me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen n gjykata ne territorin e se ciles ndodhet selia e shoqerise.

Neni 15

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

ORTAKET E SHOQËRISË "ITALIAN SOUND" Sh.P.K

Z. *Ebano Isufaj* *Ebano Isufaj* 

Z. *Luixhino Isufaj* *Luixhino Isufaj* 

Vlore me 23.07.2019